



№. 4744/ Prot  
D. 08.08.23

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PREFEKTI I QARKUT SHKODER

Nr. 523/1 prot.

Shkodër, më 08.08.2023



Lënda: Mbi vendimin nr. 57, datë 27.07.2023 të Këshillit Bashkiak Vau Dejës

KËSHILLI BASHKIAK VAU DEJËS



Prefekti i Qarkut Shkodër, në zbatim të detyrave të tij funksionale të përcaktuara në ligjin nr. 107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", neni 8, shkronja "a", të Urdhërit të Kryeministrit nr. 50, datë 12.04.2017 "Për miratimin e detyrave të administratës së Prefektit të Qarkut", të Urdhërit të MB nr. 175, datë 09.07.2020 "Për miratimin e rregullores së brëndshme "Për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut", si dhe aneksin I, "Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollin nga Prefekti i Qarkut", të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar, neni 37, pika 1, shkronja "c", neni 54, shkronja "dh", neni 55, pika 3, neni 64, shkronja "c", të ligjit nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", të ndryshuar, neni 28, pika 1, shkronja "a", të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën me Shqipërisë" i ndryshuar, të Udhëzimit të MFE nr. 9, datë 20.03.2018 "Për procedurat standarte të zbatimit të Buxhetit", pika 100, të Udhëzimit Plotësues të MFE nr. 2, datë 19.01.2023 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2023", të VKB Vau Dejës nr. 84, datë 23.12.2022 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2023 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2023-2025, numrin e punonjësve të Bashkisë Vau Dejës", të ndryshuar, të shkresës së Këshillit Bashkiak Vau Dejës nr. 4740 prot., datë 02.08.2023 "Mbi dokumentacionin e mbledhjes së Këshillit Bashkiak Vau Dejës, datë 27.07.2023", shqyrtoi VKB Vau Dejës nr. 57, datë 27.07.2023 "Për miratimin e shtesës së planit në buxhetin e Bashkisë Vau Dejës për vitin 2023", me shtesë plani në buxhet në shumën 12.547.584 lekë si shtesë fondesh sipas shkresës së MFE nr. 12674, datë 10.07.2023 "Dërgohet akorimi i fondit për rritjen e pagave në zbatim të Vendimit nr. 328, datë 31.05.2023".

Për sa trajtuar, Prefekti ju autorizon të procedoni.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

P R E F E K T I

Majlinda ANGONI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA VAU DEJËS  
KËSHILLI BASHKIAK



V E N D I M

Nr 57 Dt 27.07.2023

PËR

**“MIRATIMIN E SHITESËS SË PLANIT NË BUXHETIN E BASHKISË VAU DEJËS  
PËR VITIN 2023”**

Bazuar në nenin 54 shkronja “dh”, të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore“ i ndryshuar, të ligjit nr 68/2017 ”Për financat e veteqeverisjes vendore”, ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar, Udhëzimin te Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar, Udhëzimit plotësues nr 2, datë 19.01.2023 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2023”, VKB nr 84 datë 23.12.2022 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2023 dhe programit buxhetor afatmesëm 2023-2025 të Bashkisë Vau Dejës, dhe me shkresë nr 24/1 dt 12.01.2023 të miratuar nga Prefektura Shkodër, VKM nr 328 datë 31.05.2023 “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore”, sipas shkresës së Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr 12674 datë 10.07.2023 “Dërgohet akordimi i fondit për rritjen e pagave në zbatim të Vendimit nr.328, datë 31.5.2023”, dhe sipas relacionit te përgatitur nga Administrata e Bashkisë, Këshilli Bashkiak pasi diskutoi materialin e paraqitur në mbledhjen e tij të datës 27.07.2023

**VENDOSI:**


1. Miratimin e shtesës së planit në buxhetin e Bashkisë Vau Dejës për vitin 2023, sipas Formatit Nr 1:

2. Ky vendim i shtrinë efektet financiare nga data 01.04.2023 deri me datë 31.12.2023.
3. Ngarkohet Drejtoria Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore për zbatimin e këtij vendimi.
4. Fond i pagave përballohet nga transfertat dhe të ardhurat e bashkisë
5. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55 pika 6 të ligjit nr 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore").

**Sekretari i Këshillit Bashkiak**

**Zv/Kryetare e Këshillit Bashkiak**

  
**Ardian Celepija**

  
**Paola Pleshaj**

Miratuar me 16 vota

Vota Pro 16

Vota Kundër -

Vota Abstenim -

Zbardhur me datë 01 . 08 . 2023 .

**Institucioni: Bashkia Vau Dejës**

Formati Nr. 1 Rishpërndarje e planit të pagave sipas shkresës nr 12674 datë 10.07.2023 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë "Dërgohet akordimi i fondit për rritjen e pagave në zbatim të Vendimit nr.328, datë 31.5.2023"

**PAKESOHET**

Entit. i Qev.	Min.e Linjës	Kod Instit.	Kap.	Programi	Kod Produkti	Llog. Ekon.	Kodi i Degës se Thesarit	Debiti	Emer Institucioni
157	00	2157001	01	4960	90005AA	6040000	3333	12,547,584.00	Bashkia Vau-Dejës
<b>SHUMA</b>									
								<b>12,547,584.00</b>	

*Në Lekë***SHTOHET**

Entit. i Qev.	Min.e Linjës	Kod Instit.	Kap.	Programi	Kod Produkti	Llog. Ekon.	Kodi i Degës se Thesarit	Debiti	Emer Institucioni
157	00	2157001	01	01110	9999999	6000000	3333	7,111,125.00	Bashkia Vau-Dejës
157	00	2157001	01	01110	9999999	6010000	3333	1,146,977.00	Bashkia Vau-Dejës
157	00	2157001	01	04240	9999999	6000000	3333	864,000.00	Bashkia Vau-Dejës
157	00	2157001	01	04240	9999999	6010000	3333	144,288.00	Bashkia Vau-Dejës
157	00	2157001	01	04260	9999999	6000000	3333	274,128.00	Bashkia Vau-Dejës
157	00	2157001	01	04260	9999999	6010000	3333	35,070.00	Bashkia Vau-Dejës
157	00	2157001	01	04520	9999999	6000000	3333	594,000.00	Bashkia Vau-Dejës
157	00	2157001	01	04520	9999999	6010000	3333	99,198.00	Bashkia Vau-Dejës
157	00	2157001	01	06260	9999999	6000000	3333	1,952,900.00	Bashkia Vau-Dejës
157	00	2157001	01	06260	9999999	6010000	3333	325,898.00	Bashkia Vau-Dejës
<b>SHUMA</b>								<b>12,547,584.00</b>	

*Në Lekë***Nëpunësi Zbatues**

Elsa Tanushi

**Nëpunësi Autorizues**

Kristian Shkreli

